



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA**  
**KUVENDI I KOMUNËS –SUHAREKË**  
**MUNICIPAL ASSEMBLY- SUHAREKË-**  
**SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA**



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (d) të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisje lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 8, lidhur me nenin 21, të Ligjit për financat e pushtetit lokal, Nr. 03/L-049, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-27/2008”, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-108 “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2016”, e konform nenit, 28, paragrafi 2, pika (b), 29, paragrafi 2, pika (c) dhe 56, te Statutit të Komunës në Suharekë, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës së Suharekës, në mbledhjen e mbajtur më datën, 23.11.2018, miraton këtë;

## V E N D I M

### Neni 1

Me këtë vendim zjarrfikësit dhe anëtarët e familjes së ngushtë të tyre, **LIROHEN** nga pagesat në shërbimet mjekësore parësore që ofrohen nga organet shëndetësore në tërë territorin e Komunës së Suharekës.

### Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, Qendra Kryesore e mjekësisë familjare, Qendrat e mjekësisë familjare dhe Ambulantët.

### Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, nenit 8, të Rregullores (QRK), Nr-01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

## KUVENDI I KOMUNËS –SUHAREKË

01-Nr-016-74587  
Me datë 26.11.18

